



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.04.2022

MBLEDHJA Nr. 16,
datë 11.04.2022, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 11.04.2022, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 16 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 31.03.2022
2. Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e ERE-s nr.60, datë 25.02.2021, “Mbi miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”
3. Mbi shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e kodit të transmetimit
4. Mbi kualifikimin dhe pajisje me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjise elektrike “Hec Moglicë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për vitin 2020 dhe 2021
5. Mbi licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik i Digës Qyrmaq, Hec Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5143 kWp
6. Mbi licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Blue 1”, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW
7. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me nr. 390, seria F17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 174, datë 26.10.2017
8. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me nr. 377, seria T17 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 27.07.2017
9. Mbi kërkesën e koncesionarit “Teodori” sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë koncesionare “Teodori 2003” sh.p.k., nr. 87, seria PV09K

dhënë me vendimin e bordit nr. 83, datë 04.11.2009, për një afat 30 vjeçar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Zalli i Bulqizës” dhe Hec “Ternovë”, tek shoqëria “Teodori” sh.p.k.

10. Mbi zgjatjen e afatit për depozitimin nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) për miratim në ERE të kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe kritereve për përzgjedhjen e tij
11. Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 489, seria P21, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Gerti” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.04.2021
12. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI